

VENDIM
Nr. 107, datë 27.7.2012

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO 4”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio 4”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

Me vendimin nr. 797, datë 17.4.2009, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “Antipatrea” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio 4” me nr. licence nr. 078/FM, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor në fushën e transmetimeve radiofonike analoge për të mbuluar me sinjal qytetin e Beratit. Vendimi i KKRT-së për dhënien e licencës ka hyrë në fuqi në datën 14.5.2009 dhe afati i përfundimit të licencës ka qenë data 15.5.2012.

KKRT-ja, me shkresën nr. 321 prot., datë 29.2.2012, ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, si dhe ka kërkuar, nga ky i fundit, depozitimin e aplikimit për rinovim licence. Pavarësisht njoftimit zyrtar të KKRT-së, nga ana e subjektit, nuk është depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime financiare për vitet 2009, 2010 dhe 2011 ndaj institucionit dhe Buxhetit të Shtetit në masën 71.400 lekë, nga këto, pagesë vjetore për licencë në masën 52.000 lekë dhe tarifë për shërbimin RTV në masën 19.200 lekë.

Detyrimet e mësipërme i janë bërë me dije subjektit radiofonik me shkresat nr. 231 prot., datë 9.3.2009, nr. 630 prot., datë 9.6.2009, nr. 296 prot., datë 15.2.2010, nr. 817 prot., datë 23.7.2010, nr. 786 prot., datë 23.7.2010, nr. 72 prot., datë 17.1.2011 dhe nr. 800 prot., datë 29.4.2011. Së fundmi, me shkresën nr. 769 prot., datë 5.6.2012, është ripërsëritur kërkesa për shlyerjen e detyrimeve, duke caktuar si afat përfundimtar datën 15.6.2012.

Në vijim, me shkresën nr. 1050 prot., datë 13.7.2012, KKRT-ja ka njoftuar subjektin radiofonik privat vendor “Radio 4” se në mbledhjen e radhës, në rast mosshlyerje të detyrimeve, do të vijonte me procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Gjithashtu, subjekti është njoftuar për të drejtën për t’u dëgjuar, duke marrë pjesë në mbledhje apo duke paraqitur pretendimet mbi çështjen.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. Kërkuesi... nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio 4”, me nr. 078/FM.
 2. Subjekti radiofonik privat vendor “Radio 4” të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja në dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati